

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E STACIONEVE TRASMENTUESE RTV TIRANË

Raporti Përfundimtar “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e aktivitetit data 01.01.2012 deri më 30.09.2013, kryer në Drejtoria e Stacioneve Transmetuese RTV Tiranë me objekt: *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë; mbi rregullshmërinë në evidentimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave; mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e pagave, shpërblimeve dhe honorarëve, si dhe për dhënien me qira të ambienteve; ligjshmëria e prokurimeve etj.”* është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 183 datë 31.12.2013.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 842/7 prot., datë 31.12.2013 dërguar z. Arben Mëhilli, Drejtor i Drejtorisë Stacioneve Transmetuese RTV Tiranë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave organizative dhe për shpërblim dëmi.

Si masa organizative, midis të tjerave janë rekomanduar dhe kërkuar:

- rishikimi dhe të përditësimi i Rregullores së brendshme të funksionimit të DST RTV, duke përcaktuar detyrat në detaje për secilin vend pune në mënyrë të veçantë dhe sigurimin e monitorimit të performancës së këtyre strukturave.
- marrja e masave të nevojshme për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të gjitha objektet e regjistruar në kontabilitet.
- marrja e masave për nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve (përfshirë dhe mjetet e transportit) që janë stoqe prej vitesh, për të pasqyruar gjendjen reale të pasurisë së institucionit.
- përcaktimi i saktë i distancave të vendndodhjes së pikave transmetuese, të cilat shërbejnë për përlllogaritjen e shpenzimeve për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
- marrja masa, për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, të nxjerrjes jashtë përdorimi të mallrave në magazinë, si dhe të asgjësimit të këtyre të fundit, duke u bazuar në normat ligjore të amortizimit.
- hartimi i regjistrit të riskut dhe të caktimit të nëpunësit autorizues e zbatues me detyrat përkatëse sipas përcaktimeve në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe udhëzimit për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.
- marrja e masave për t’u fokusuar në zhvillimin e sistemeve të IT me qëllim përmirësimin e aktiviteteve të kontrollit, në funksion të administrimit dhe menaxhimit më të mirë të institucionit.

Si masë për shpërblim dëmi është kërkuar arkëtimi i vlerës prej vlera prej **75,920 lekë** të përfituara padrejtësisht për udhëtime e dieta, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” dhe të Vendimit të Këshillit Drejtues të RTSH.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi u krye nga z. Nefail Xhepexhiu përgjegjës i grupit, z. Andi Buzo dhe zj. Keida Muça. Më tej u shqyrtua nga z. Gjovalin Preçi Kryeauditues, Drejtori i Departamentit z. Xhafer

Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHITIT